

VENDIM
Nr.94, datë 21.1.2009

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2009, PËR
MINISTRINË E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, PËR
KRYERJEN E STUDIMIT PËR ULLIRIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit t’i shtohet fondi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, për kryerjen e studimit të plotë, në shkallë vendi, për gjendjen aktuale të kulturës së ullirit dhe për perspektivën e zhvillimit.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

PREVENTIV MBI PËRDORIMIN E FONDIT PËR STUDIMIN E ULLIRIT

Nr.	Aktiviteti	Njësia	Sasia	Çmimi lekë për njësi	Vlera në lekë
1.	Hartografim i të dhënave për rajonizimin	Ha	50 000	100	5 000 000
2.	Analiza të plota agro- pedagogjike	Ha	50 000	60	3 000 000
3.	Grumbullim të dhënash statistikore	Ditë	400	4000	1 600 000
4.	Ekspertizë me ekspert vendas (pagë +shërbime)	Ditë (5 ekspertë x 30 ditë)	150	8000	1 200 000
5.	Ekspertizë me ekspertë të huaj	(1 ekspert)	30	70 000	2 100 000
6.	Shpenzime të tjera (përpunim të dhënash, printime të materialit të studimit etj.)				2 100 000
	TOTALI				15 000 000